REPUBLIKA E KOSOVËS
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Gjykata Kushtetuese / Ustavni sud / Constitutional Court
Adresa: Perandori Justinian, PN. Prishtinë
T: +381 (0)38 220 104; F: +381 (0)38 220 112; www.gjk-ks.org

Prishtinë, datë: 15 dhjetor 2009
Ref.: Nr. MP-03/09

# VENDIM

## Mbi kërkesën për vënien e Masave të përkohshme në

## Rastin Nr. KI. 22/09

### Dedë Gecaj vs. Vendimit PKL-KZZ 76/08 të Gjykatës Supreme

### GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

Në përbërjen për sa vijon:

Enver Hasani, kryetar
Snezhana Botusharova, gjyqtar
Robert Carolan, gjyqtar
Ivan Čukalović, gjyqtar
Iliriana Islami, gjyqtar
Kadri Kryeziu, gjyqtar
Gjylieta Mushkolaj, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar, dhe
Altay Suroy, gjyqtar

Me z-shën Albana Sopi, si procesmbajtës i këshillimit dhe votimit të Gjykatës, mbajtur më 25 nëntor 2009, për Kërkesën rreth vënies së masave të përkohshme në rastin Nr. KI 22/09 të paraqitur më 22 Qershor 2009 në këtë Gjykatë:

**Kërkuesi**

1. Zt. Dedë Gecaj, përfaqësuar nga Dr. Kolë Krasniqi, avokat në Pejë.

**Objekti i shqyrtimit**

2. Kërkuesi, ka parashtruar Kërkesën në Gjykatë më 22 qershor 2009, në të cilën pohon se të drejtat e tija kushtetuese janë cenuar me Vendimin PKL-KZZ 76/08 të Gjykatës Supreme të Kosovës të datës 6 prill 2009, me të cilin vendim Gjykata Supreme ka shpallur si të vlefshëm Marrëveshjen për Ekstradim të zt. Dedë Gecaj, e lidhur ndërmjet autoriteteve të UNMIK-ut dhe atyre të Zvicrës më datën 20 gusht

2007. Më datën 17 shtator 2009, Kërkuesi përmes avokatit të tij ka kërkuar vënien e masave të përkohshme, duke kërkuar pezullimin e procedurës në vijim për ekstradim të tij në Zvicër. Ai ka pohuar se ekstradimi i tij eventual cenon "të drejtën ndërkombëtare" dhe "standardet ndërkombëtare mbi të drejtat e njeriut".

3. Në parashtresat e datës 17 shtator 2009, përfaqësuesi i Kërkuesit ka kërkuar që Gjykata t'i pezullojë procedurat e filluara të ekstradimit të klientit të tij për në Zvicër.

**Baza juridike**

4. Neni 116 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës (më tej shkurt: Kushtetuta), neni 27 i Ligjit Nr. 03/L-121 mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës të datës 16 dhjetor 2008 (më tej shkurt: Ligji), neni 52 (1) i Rregullave të Procedurës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (më tej shkurt: Rregullat e Procedurës).

**Faktet**

5. Në Janar të vitit 1999, Kërkuesi, i cili jetonte në Zvicër, siç duket ka vrarë mësuesin e vajzës së tij dhe është arratisur. Me 25 Shkurt 1999, ai u arrestua në Gjakovë, Kosovë, dhe u dënua në bazë të Ligjit mbi Veprat Penale të Federatës Socialiste të Jugosllavisë të vitit 1977. Pasi që ai u paraqit para Gjykatës së Qarkut në Pejë më 1 Mars 1999, Gjykata Supreme e Republikës së Serbisë ndryshoi vendin e lëndës nga Gjykata e Qarkut në Pejë në atë të Qarkut në Leskovc, e cila e dënoi atë për vrasje me 4 vjet burgim.

6. Në pritje të ankesës së tij para Gjykatës Supreme të Serbisë, Kërkuesi u lirua. Me 20 Mars 2002 dhe 28 Mars 2003, Gjykata Supreme konfirmoi dënimin e tij, por i zvogëloi dënimin në 3 vjet dhe 6 muaj burgim. Kërkuesi, deri më tani, nuk e ka mbajtur pjesën e mbetur të dënimit të tij.

7. Më 19 Maj 2003 si dhe më 6 Dhjetor 2005, autoritetet Zvicerane lëshuan një thirrje për arrestimin e Kërkuesit për veprat e kryera në Zvicër. Me 22 Shkurt 2006, një Marrëveshje u arrit në mes të autoriteteve Zvicerane dhe UNMIK-ut lidhur me Ekstradimin e Kërkuesit. Ai u arrestua në Kosovë me 4 Maj 2006 dhe po të njëjtën ditë u lirua.

8. Më 17 Gusht 2007 u dha urdhri për paraburgimin tij për shkak të akuzave të ndryshme dhe me 20 Gusht 2007 u arrit një Marrëveshje e re në mes të Autoriteteve Zvicerane dhe UNMIK-ut. Procedurat gjyqësore, të cilat i inicioi Kërkuesi me qëllim Marrëveshja të shpallej e pavlefshme të, përfunduan në Gjykatën Supreme të Kosovës dhe me datën 6 Prill 2009, Marrëveshja u shpall e vlefshme, dhe kodi "ne bis in idem", i paraqitur nga Kërkuesi, nuk ishte i aplikueshëm.

**Pohimet e Kërkuesit**

9. Kërkuesi u ankua se Vendimi Nr. PKL-KZZ 76/08 i Gjykatës Kushtetuese të Kosovës i datës 6 Prill 2009, nuk respektoi kodin "ne bis in idem", pasi që Gjykata Supreme e Serbisë veçse kishte shpallur rastin me vendim të formës së prerë. Po ashtu, ai pohoi se Vendimi i lartpërmendur nuk respektoi Nenin 517.9 të Kodit të

Përkohshëm Penal të Kosovës, i cili parasheh që zhvendosja e një personi për një gjykim të jashtëm mund të lejohet vetëm nëse vërtet nuk rrezikohet që personi në fjalë mund të ballafaqohet me një dënim jo njerëzor ose të degraduar.

10. Sipas mendimit të Kërkuesit, autoritetet Zvicerane kanë vepruar në mënyrë të paligjshme, diskriminuese dhe hakmarrëse për shkak të nacionalitetit të tij dhe urrejtjes së tyre kundrejt të huajve.

11. Kërkuesi nuk ka përmendur ndonjë nen të caktuar të Kushtetutës.

## GJYKATA KUSHTETUESE

Pasi ka dëgjuar gjyqtarin raportues të rastit, z-njën Gjyljeta Mushkolaj, ka shqyrtuar në tërësi parashtresat e Kërkuesit lidhur me kërkesën e tij për vënien e masave të përkohshme, të paraqitur përmes avokatit të tij, më 25 nëntor 2009 dhe ka ardhur në përfundimin se Kërkesa duhet te pezullohet. Gjykata gjeti se Kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë provë e cila arsyeton pezullimin e ekstradimit. Në veçanti, ankesa e Kërkuesit se ekstradimi i tij në Zvicër do ta shpinte atë drejt trajtimit jo njerëzor ose të degraduar, në kundërshtim me Nenin 3 të Konventës Evropiane mbi të Drejtat e Njeriut, nuk është vërtetuar. Gjithashtu Kërkuesi nuk ka dëshmuar se ai do të ketë dëme të pariparueshme, nëse Gjykata kundërshton kërkesën e tij për masa të përkohshme.

## PËR KËTO ARSYE

Mbështetur në nenin 116 (2) të Kushtetutës, nenin 27 (1) të Ligjit, si dhe në nenin 52 (1) të Rregullave të Procedurës, Gjykata me shumicë votash,

## VENDOSI

I. REFUZOHET Kërkesa për masat e përkohshme

II. Vendimi u dërgohet palëve

III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në pajtim me nenin 20(4) të Ligjit.

**Gjyqtari Raportues** | **Kryetari i Gjykatës Kushtetuese**

Ass. Prof. Dr. Gjyljeta Mushkolaj | Prof. Dr. Enver Hasani

REPUBLIKA E KOSOVËS * GJYKATA KUSHTETUESE-PRISHTINË * REPUBLIKA KOSOVO * USTAVNI SUD-PRIŠTINA